



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 40-k dhe nenit 40-l paragrafi (3) të Ligjit për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 104/1009 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 14/20, 174/21, 298/21, 67/22 dhe 65/23), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20), nenit 22, nenit 23 dhe nenit 24 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe nenit 2 të Rregullores për elementet e detyrueshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së udhëheqjes së regjistrit të personave që kanë parashtruar të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/15), dhe nenit 3 të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 01-566/1 të datës 29.1.2021, nr. 01-4692/1 të datës 30.8.2023, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër amë 4064682, numër të vetëm tatimor 4030946338843, publikon

**SHPLLJE PUBLIKE NUMËR 1/2023**  
për punësim të pesë (5) personave ndihmës-teknik në shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut  
për kohë të pacaktuar në vendet e punës në vijim:

1. **Korrier**, niveli A3, shifra UPR 04 05 A03 001, në Sektorin për çështje administrative, në Departamentin për punë zyre dhe arkivore – Sportel – dy (2) realizues  
**Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:**

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

**Kushtet e veçanta:**

- arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

**Orari i kohës së punës:**

Ditët e punës: e hënë – e premte;  
Orët e punës gjatë javës: 40 orë;

Orari i punës: nga ora 8:30 deri në ora 16:30

Shuma e neto pagës për vendin e punës me numër rendor 1 është 26.559 denarë.

**VËREJTJE:** Punësimet e parapara sipas Planit vjetor të institucionit për vitin 2023 për vendin e punës me numër rendor 1 janë: 1 maqedonas/e dhe 1 shqiptar/e

2. **Punëtor për realizimin e punëve ndihmëse**, niveli A3, shifra UPR 04 05 A03 007, në Sektorin për çështje teknike, në Departamentin për mirëmbajtje investuese dhe aktuale dhe çështje të përgjithshme – dy (2) realizues

**Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:**

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

**Kushtet e veçanta:**

- arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

**Orari i kohës së punës:**

Ditët e punës: e hënë – e premte;  
Orët e punës gjatë javës: 40 orë;

Orari i punës: nga ora 8:30 deri në ora 16:30

Shuma e neto pagës për vendin e punës me numër rendor 2 është 26.559 denarë.

**VËREJTJE:** Punësimet e parapara sipas Planit vjetor të institucionit për vitin 2023 për vendin e punës me numër rendor 2 janë: 1 maqedonas/e dhe 1 rom/e.

3. **Shofer II**, niveli A2, shifra UPR 04 03 A02 001, në Sektorin për mbështetje të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit, në Departamentin për çështje protokollare – 1 (një) realizues

**Kushtet e përgjithshme të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:**

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë gjendje të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos ketë të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

**Kushtet e veçanta:**

- arsim i mesëm
- përvojë e punës prej së paku një (1) vit si shofer profesional
- Leje të voziljes të kategorisë B

**Orari i kohës së punës:**

Ditët e punës: e hënë – e premte;

Orët e punës gjatë javës: 40 orë;

Orari i punës: nga ora 8:30 deri në ora 16:30

Shuma e neto pagës për vendin e punës me numër rendor 3 është 28.200 denarë.

**VËREJTJE:** Punësimet e parapara sipas Planit vjetor të institucionit për vitin 2023 për vendin e punës me numër rendor 3 janë: 1 (një) maqedonas/e.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët parashtrorë fletëparaqitje për punësim në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilin mund ta marrin nga ueb faqja e Kuvendit, të publikuar në kategorinë Kuvendi Transparent, në pjesën Shpallje (<http://www.sobranie.mk>). Fletëparaqitjen e plotësuar në tërësi dhe me të dhëna të sakta, së bashku me dëshmitë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në të cilin kanë konkurruar, kandidatët mund t'i parashtrorë me zarf të mbyllur përmes Sportelit të Kuvendit ose përmes postës me shënim: "Shpallje për punësim të personave ndihmës-teknik nr. 1/2023", në adresën në vijim:

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut rr. "11 Oktomvri" nr. 10, 1000 Shkup.

Kandidatët me fletëparaqitjen e nënshkruar me dorë për vendin e punës duhet t'i parashtrorë dëshmitë për plotësimin e kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter edhe atë:

- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë që me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk ka të shquar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë nga historiat i punësimeve nga Agjencia e punësimit të RMV si dëshmi për përvojën e punës;
- Diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit (të gjitha dëftesat për arsim fillor dhe të gjitha dëftesat për arsim të mesëm duke përfshirë edhe diplomën për arsimin e mesëm të mbaruar;
- Vërtetim mjekësor për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;

- Biografi të shkurtë me kontakt telefoni dhe adresë.

Afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e duhura është tre (3) ditë pune, duke mos e llogaritur ditën e publikimit të shpalljes. Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Përzgjedhja do të bëhet në varësi të kandidatëve të paraqitur dhe nëse për një vend pune janë paraqitur deri në 200 kandidatë, përzgjedhja bëhet brenda 45 ditëve, nga 201 deri në 500 kandidatë për një vend pune, përzgjedhja bëhet brenda 90 ditëve dhe mbi 500 kandidatët për një vend pune, përzgjedhja bëhet brenda 120 ditëve, pas përfundimit të afatit për paraqitje.

Procedura e përzgjedhjes do të kryhet në dy faza: përzgjedhje administrative (verifikimi i plotësisë së fletëparaqitjes dhe provave) dhe intervistë.

Me rastin e parashtrimit të fletëparaqitjes, personi thekson numrin e vendit të punës për të cilin paraqitet.

Kandidatët janë të detyruar të paraqesin të dhëna precize dhe të sakta. Përzgjedhja administrative dhe intervistimi i kandidatëve të paraqitur do të bëhet nga Komisioni kompetent i krijuar për zbatimin e procedurës së punësimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Kandidatët e paraqitur do të njoftohen menjëherë për kohën dhe vendin e intervistës.

Pas realizimit të fazave, Komisioni përgatit listën përfundimtare për vendin e punës nga shpallja publike, e cila i dorëzohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, i cili bën përzgjedhjen brenda 8 ditëve.

Vendimi për përzgjedhjen e kandidatëve do të publikohet në ueb faqen e Kuvendit <http://www.sobranie.mk>.